

KONTRATË
MBI "THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË"
" MOTO RENTAL "

Sot, me datë **22/04/2024**, në Shkodër, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

Z. Eni Llazani, shtetas shqiptar, lindur më **30/11/1989** dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **I91130066J**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe **Z. Çarli Luka**, shtetas shqiptar, lindur më **21/06/1995** dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J50804106U**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

vendosën të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anëtarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Emri i shoqërisë së thjeshtë është "**Moto Rental**", këtu e më poshtë e quajtur "**Shoqëria**". Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.



NENI 2

Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Kardinal Mikel Koliqi, Lagja Tom Kola, zona kadastrale 8593, Shkodër.**

Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

NENI 3

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë;

Dhënie me qera të mjeteve të transportit (motorike).

NENI 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

NENI 5

Kapitali Themelor dhe Ortakët

Kapitali i Shoqërisë është 200.000 Lekë (dyqind mijë).

Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportet e mëposhtme;

-nga Z. Eni Llazani, 50% e kapitalit, me 1 kuotë, 100.000 lek kapital

-nga Z. Çarli Luka, 50% e kapitalit, me 1 kuotë, 100.000 lek kapital

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.



NENI 6
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

NENI 7
Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Znj. Eni Llazani, shtetas shqiptar, lindur më **30/11/1989** dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **I91130066J**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Mandati i Administratorit është për një periudhe prej 5 (pesë) vitesh, nga data **22.04.2024** – **22.04.2029**. I rinovueshem, dhe, nese është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



NENI 8
Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

Përgjatimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe përfundon me 31 Dhjetor 2024.

NENI 9
Të ndryshme

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

ORTAKËT E SHOQËRISË

ENI LLAZANI

Eni Llazani:



CARLI LUKA

Carli Luka

